



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr.147, date 28.04.2020**

**PËR**

**NDRYSHIMIN E PIKËS 2 TË VENDIMIT NR.131, DATË 30.03.2020 TË KËSHILLIT  
TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke u bazuar në nenin 62/14 dhe nenin 89 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimet e tij nr. 126, datë 19.07.2019 dhe nr. 317, datë 19.12.2019, me propozim të Komisionit të Përkohshëm për Hartimin e një Plani Veprimesh Lidhur me Reduktimin e Çështjeve të Prapambetura dhe Rritjen e Efikasitetit në Gjykatën e Lartë,

**V E N D O S I:**

1. Ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr.131, datë 30.03.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe miratimin e përmbajtjes së Memorandumit të Mirëkuptimit, sipas tekstit të ndryshuar (i bashkëlidhur), ku palë nënshkruese të tij do të jenë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**